



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.5.2023

Nr: 426

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË AGJENCISË TELEGRAFIKE SHQIPTARE (ATSH), SHOQËRISË “PANORAMA GROUP”, TELEVISIONI “VIZION PLUS”, TELEVISIONI “EURONEWS”, TELEVISIONI “A2 CNN”, QENDRA “BIRN ALBANIA”, “MAT TELEVISION”, MEDIAT ONLINE “BULQIZA IME” DHE “SARANDA WEB”, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot në datën 3.5.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

- KËRKUES:** Agjencia Telegrafike Shqiptare me adresë Rruga “Ismail Qemali”, Tiranë dhe me përfaqësues zj. Valbona Zhupa;
- Shoqëria “Panorama Group” me adresë Rruga “Panorama”, Ndërtesa nr. 3, Tiranë dhe me përfaqësues z. Ardit Çela;
- Televizioni “Vizion Plus” me adresë Rruga “Don Bosko”, nr. 5, Tiranë dhe me përfaqësues z. Arban Hasani;
- Televizioni “Euronews” me adresë Rruga “Rezervat e Shtetit” dhe me përfaqësues z. Bjorn Xhokaxhi;
- Televizioni “A2 CNN” me adresë Rruga “Papa Gjon Pali 2” dhe me përfaqësues z. Andri Kasneci;
- Qendra “BIRN ALBANIA” me adresë Rruga “Nikolla Jorga”, pallati 8, Tiranë dhe me përfaqësues zj. Kristina Voko;
- “Mat Televizion” me adresë Lagja “Partizani”, Burrel dhe me përfaqësues z. Luftim Vani;

Data: 3.5.2023 Nr: 426
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), Shoqërisë “Panorama Group”, Televizioni “Vizion Plus”, Televizioni “Euronews”, Televizioni “A2 CNN”, Qendra “Birn Albania”, “Mat Televizion”, Mediat Online “Bulqiza Ime” dhe “Saranda Web”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Media online “Saranda Web” me adresë Rruga “Skënderbeu 9701”, Sarandë dhe me përfaqësues z. Uesli Didani;

Media online “ Bulqiza ime” me adresë “Lagjja e re”, Rruga “Këshilli i Rrethit” dhe me përfaqësues z. Sami Curri;

OBJEKTI Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të Medias për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.1.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

V Ë R E J:

Agjencia Telegrafike Shqiptare (ATSH) i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 10 (dhjetë) gazetarë dhe operatorë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Agjencia Telegrafike Shqiptare është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Shoqëria “Panorama Group” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 17 (shtatëmbëdhjetë) gazetarë dhe operatorë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Shoqëria “Panorama Group” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni “Vizion Plus” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 74 (shtatëdhjetë e katër) gazetarë dhe operatorë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni “Vizion Plus” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni “Euronews” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 82 (tetëdhjetë e dy) gazetarë dhe operatorë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni “Euronews” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni “A2 CNN” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 73 (shtatëdhjetë e tre) gazetarë dhe operatorë si dhe zonat e

Data: 3.5.2023 Nr: 426
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), Shoqërisë “Panorama Group”, Televizioni “Vizion Plus”, Televizioni “Euronews”, Televizioni “A2 CNN”, Qendra “Birr Albania”, “Mat Televizion”, Mediat Online “Bulqiza Ime” dhe “Saranda Web”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni “A2 CNN” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Qendra “BIRN ALBANIA” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 8 (tetë) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Qendra “BIRN ALBANIA” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

“Mat Televizion” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 7 (shtatë) gazetarë dhe operatorë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. “Mat Televizion” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Media online “Saranda Web” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 1 (një) gazetar si dhe zonën e vëzhgimit të tij. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Media online “Saranda Web” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Media online “Bulqiza ime” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 15 (pesëmbëdhjetë) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Media online “Bulqiza ime” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S :

1. Akreditimin e 10 (dhjetë) gazetarëve dhe operatorëve të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Data: 3.5.2023 Nr: 426
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), Shoqërisë “Panorama Group”, Televizioni “Vizion Plus”, Televizioni “Euronews”, Televizioni “A2 CNN”, Qendra “Birn Albania”, “Mat Televizion”, Mediati Online “Bulqiza Ime” dhe “Saranda Web”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

2. Akreditimin e 17 (shtatëmbëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve të Shoqërisë “Panorama Group”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin e 74 (shtatëdhjetë e katër) gazetarëve dhe operatorëve të Televizionit “Vizion Plus”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin e 82 (tetëdhjetë e dy) gazetarëve dhe operatorëve të Televizionit “Euronews”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Akreditimin e 73 (shtatëdhjetë e tre) gazetarëve dhe operatorëve të Televizionit “A2 CNN”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
6. Akreditimin e 8 (tetë) gazetarëve të Qendrës “BIRN ALBANIA”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
7. Akreditimin e 7 (shtatë) gazetarëve të “Mat Televizion”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
8. Akreditimin e 1 (një) gazetari të “Saranda Web”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
9. Akreditimin e 15 (pesëmbëdhjetë) gazetarëve të “Bulqiza Ime”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 3.5.2023 Nr: 426
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), Shoqërisë “Panorama Group”, Televizionit “Vizion Plus”, Televizionit “Euronews”, Televizionit “A2 CNN”, Qendra “Birn Albania”, “Mat Televizion”, Mediat Online “Bulqiza Ime” dhe “Saranda Web”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.